



Raport mbi veprimtarinë vjetore të investimit të mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme.

Në zbatim të ligjit Nr. 53/2014 “Për Sigurimin e Depozitave”, i ndryshuar, ligjit nr. 133, datë 22.12.2016 “Për Rimëkëmbjen dhe Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme në Banka, në Republikën e Shqipërisë”, vendimit të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë Nr.56, datë 03.10.2017 për miratimin e rregullores “Për Fondin e Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme dhe procedurat për administrimin e tij”, Agjencia e Sigurimit të Depozitave, administron fondin e Ndërhyrjes së jashtëzakonshme. Agjencia për të kryer një aktivitet efektiv administrimi, ka hartuar Politikën e Administrimit të Mjeteve Financiare e cila është miratuar nga Banka e Shqipërisë si autoritet mbikëqyrës. Në këtë politikë përcaktohen procedurat, kriteret dhe kufijtë e përqendrimit dhe maturitetit që zbatohen nga Agjencia e Sigurimit të Depozitave për administrimin e mjeteve financiare të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme. Gjatë aktiviteti investues, Agjencia ndjek parimet e likuiditetit të lartë, rrezikut të ulët të kredisë dhe normës së lartë kthimit pas respektimit të dy parimeve të parë.

Për këtë arsye në fillim të vitit 2018, pas miratimit të Politikës e Administrimit të Mjeteve Financiare nga Autoriteti i Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme, Komiteti i Investimeve në zbatim të kësaj politike, miratoi strategjinë e investimit të kontributit vjetor të Fondit të Ndërhyrjes së Jashtëzakonshme për vitin 2018.

Në vijim të shkresës së Bankës së Shqipërisë, në muajin Janar nga të gjitha bankat e nivelit të dytë u arkëtua 10% e kontributit vjetor, në shumën prej 173,983,963.49 lekë nga të cilat 63,217,464.27 lekë përbënte 10% e kontributit vjetor për sistemin dhe pjesa tjetër i përket pagesës para kohe të kontributit vjetor nga një subjekt bankar.

Në linjë me arkëtimin gradual nga bankat, Agjencia përdori instrumentin e depozitës një javore pranë Bankës së Shqipërisë, për gjatë gjithë muajit Janar dhe Shkurt. Instrumenti i depozitës një javore është përdorur gjatë gjithë vitit për të përshtatur investimet sipas maturiteteve të përshkallëzuara, duke siguruar në të njëjtën kohë të ardhura nga interesi.

Në muajin Mars, Komiteti i Investimeve në përputhje dhe në zbatim të politikës së administrimit të mjeteve financiare të FNJ, me qëllim ruajtjen e raporteve sipas monedhës vendosi që 5% të totalit vjetor të fondit të konvertohej në monedhën euro. Ky fond ishte i barabartë me kundërvlerën e 240.000 eurove. Kjo shumë nuk është investuar por është mbajtur




në llogari pranë Bankës së Shqipërisë sepse nuk ka patur emetime titujsh të Qeverisë Shqiptare në monedhë të huaj gjatë vitit 2018. Pjesa tjetër e fondit prej 142 milion lekë pas këtij konvertimi u vendos të investohej në muajin mars 2018, në bono thesari me maturitet 12 mujor..

Në muajin prill 2018, pas arkëtimit të pjesës së mbetur të kontributit vjetor, në shumën prej 458,442,851.00 lekë, Komiteti i Investimeve mori vendim që, totali vjetor i fondit për t'u investuar të shpërndahej pothuaj në mënyrë të barabartë në maturitetin 12 mujor dhe 2 vjeçar.

Në muajin maj është bërë investimi i shumës prej 150 milion lekë në obligacione të Qeverisë Shqiptare me maturitet 24 mujor.


Në muajin Qershor për shkak të mbivlerësimit të monedhes vëndase në muajt paraardhës dhe me qëllim për të ruajtur raportet sipas monedhës, Agjencia konvertoi edhe një pjesë të fondit prej 40.000 euro duke ruajtur raportin sipas monedhave në nivelet e kërkuara në politikën e administrimit të FNJ.

Portofoli sipas monedhave



Në vijim, pjesa e mbetur e fondit u investua përkatësisht në muajin gusht në shumën 150 milion lekë në bono thesari në maturitetin 12 mujor dhe në muajin tetor shuma 131 milion lekë, në obligacion me maturitet 2 vjeçar. Agjencia e ka investuar tw gjithw kontributin vjetor në tituj të Qeverisë Shqiptarë në tregun primar.

Gjendja e depozitës në fund të vitit është në vlerën 31.840.000 lekë ndërsa nënportofoli në euro është në vlerën 34.557.600 lekë (280.000 euro)



AGJENCIA E SIGURIMITË DEPOZITAVE

Agjencia e Sigurimit të Depozitave
Rruga e Elbasanit, Nr. 317
Tiranë / Albania
t: +355 (4) 2362 989/2347 298
f: +355 (4) 2362 984
e: info@asd.gov.al
w: www.asd.gov.al

Për gjatë të gjithë vitit Agjencia është kujdesur jo vetëm për një administrim sa më efektiv të fondit por edhe duke pasur në vëmendje ruajtjen e raporteve sipas transeve dhe monedhës të përcaktuara në politikën dhe strategjinë e investimit.

Norma mesatare e kthimit e siguruar për portofolin e investuar të FNJ në mbyllje të vitit financiar 2018 është 2.09% për investimet me maturitet 12 mujor dhe 2.53% për investimet në maturitetin 24 mujor. Investimet e kryera gjatë 6-mujorit të parë të vitit kanë gjeneruar një normë kthimi më të lartë krahasuar me gjysmën e dytë të vitit, si rezultat i tendencës rënëse të normave në këtë periudhë.

Në grafikët në vijim paraqitet ndarja e mjeteve financiare të Fondit më 31 Dhjetor 2018, sipas përbërjes dhe maturitetit.

